

LEDIA DUSHKU

**ZONA E PUSHTUAR NGA GREQIA DHE PËRCAKTIMI
I KUFIRIT SHQIPTARO-GREK NË KONFERENCËN
E AMBASADORËVE NË LONDËR
(mars - gusht 1913)**

Në vend të hyrjes

Trajtimi i çështjes së kufirit shqiptaro-grek në Konferencën e Ambasadorëve në Londër jo rrallë herë është cekur nga letërsia historike shqiptare. Por mënyra se si ecuria e saj ka kushtëzuar sjelljen e politikës greke në territoret e pushtuara në Shqipërinë e Jugut, deri më tani nuk ka pasur trajtimin e duhur. Aktivizimi i diplomacisë greke në Konferencën e Londrës ishte vetëm njëra nga shtyllat e politikës së jashtme së Greqisë për të zotëruar territoret e pretenduara të Shqipërisë së Jugut. Administrimi i territoreve të pushtuara sipas interesave greke dhe në varësi të zhvillimeve të politikës së të Mëdhenjve, ishte shtylla e dytë e saj. Pikërisht ecurinë e këtyre dy shtyllave ka si qëllim të trajtojë artikulli i mëposhtëm.

Krijimi i zonës së pushtimit

Pushtimi i territoreve shqiptare prej ushtrisë greke u krye në tre faza. Faza e parë i përket muajit nëntor të vitit 1912. Në këtë fazë u pushtua zona bregdetare. Ai filloi me marrjen e Prevezës dhe u mbyll me pushtimin e Himarës dhe ishullit të Sazanit. Faza e dytë preku territoret juglindore të Shqipërisë. Nisi më 7 dhjetor 1912 me pushtimin e Bilishtin dhe përfundoi më 20 dhjetor me hyrjen e ushtrisë greke në Korçë. Faza e tretë nisi në fund të shkurtit të 1913, në kohën kur filloi ofensiva e përgjithshme e ushtrisë greke për të marrë Janinën. Më 5 mars, ushtria greke mori Ersekën, më 10, Leskovikun dhe më 15, Përmetin. Më pas ajo iu drejtua prefekturës së Gjirokastrës dhe më 16 mars 1913 pushtoi qytetin. Në mes të marsit të 1913, ushtria greke kishte arritur të pushtonte të gjithë territorin shqiptar, të cilin e pretendonte sipas memorandumit dërguar Konferencës së Ambasadorëve më 3 janar të po atij viti¹.

¹ Memorandumi grek ngrihej mbi kriterin e “arsyetimit etnologjik dhe qytetërues”. Në të gjente mbështetje qëndrimi i njohur grek, që identifikonte parimin etnik me atë fetar. Popullsia që frekuentonte fenë ortodokse shpallej greke dhe kështu e ashtuquajtura “epërsi numerike e elementit grek” sillej si argument plotësues për

Në kohën e depërtimit ushtarak, Greqia i trajtoi territoret shqiptare si territore osmane, kaheër të pretenduara prej saj. Hyrja e ushtrisë greke në tokat e shqiptare u shoqërua me uljen e flamurit shqiptar, ngritjen e atij grek² dhe marrjen në dorëzim të post-telegrafëve³. Përrjashtim bëri vetëm Himara. Ndonëse zbarkimi në zonë filloi me pëlqimin e qeverisë dhe të Komandës së Përgjithshme të ushtrisë greke, marrja e saj nuk u bë nga ushtria e rregullt greke, por nga “vendasi” me në krye Spiro Spiromilon. Ata pasi zotëruan zonën nuk ngritën aty flamurin grek, por atë “himarjot”, i cili përbëhej nga ngjyra e kaltër e flamurit grek dhe kishte shtatë yje në mes, që simbolizonin shtatë fshatrat e krahinës së Himarës⁴. Në përgjithësi ushtria greke nuk iu përgjigj politikës paqësore të qeverisë së Vlorës⁵. Veçanërisht ndaj popullsisë shqiptare që i reagoi pushtimit, sjellja e saj ishte agresive. Shprehja e komandantit grek në zonën e Tepelenës se “tokat me shpatë i zaptoi dhe me shpatë do t’i mbante në emër të mbretit të Greqisë”⁶, shpreh qartë sjelljen dhe qëllimet e saj. Informacionet në terren krahas situatave të qeta, flasin edhe për djegie fshatrash, panik në popull, dhunë fizike si ndaj shqiptarëve myslimanë ashtu edhe ndaj atyre të krishterë⁷. Depërtimi i ushtrisë greke në zonat e

aneksimit e Shqipërisë së Jugut. Gjuha e folur nuk konsiderohej kriter në përcaktimin e kombësisë. Vetëm faktori shpirtëror si “ndërgjegjja dhe vullneti i individit”, shërbente si bazë e “arsyetimit etnologjik”. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, vija kufitare e pretenduar nga qeveria greke, niste nga Himara në perëndim deri në Korçë në lindje. Kjo vijë njihet si vija Venizellos. Shih: *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1919, dos. 17, fl. 155-162. Memorandumi grek i vitit 1913 në Konferencën e Londrës.

² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), (Koleksion i fondeve personale deri në vitin 1912), Fondi 441, dos. 846. Shënimet e Thoma Papapanos.

³ Νικολαΐδου Ι. Ελευθερία, “Οργάνωση του κράτους στην ανελευθερομένη Ήπειρο (1913-1914)”, *Δοδωνη*, Volumi XVI, Ιωάννινα: 1987; (Shfrytëzuar materiali në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-IV-451, Eleftheria Nikolaidhu, “Organizimi i shtetit në Epirin e çliruar, 1913-1914”, *Dodona*, vol. XVI, 1987).

⁴ Për më shumë në lidhje me pushtimin e Himarës dhe arsytet pse aty nuk u ngrit flamuri grek shih: Ledia Dushku, “Shqipëria dhe Greqia në rrjedhën e Luftës së Parë Ballkanike (tetor-nëntor 1912)”, në *Studime historike*, Nr. 3-4, Tiranë: 2007, f. 59-61.

⁵ *AIH*, A-IV-330, fl. 16. (Autori transmeton telegramin e ministrit të Brendshëm të qeverisë së Vlorës, Myfid Libohovës për komandantin grek në Gjirokastër, dt. 13 mars 1913).

⁶ *Po aty*, fl. 17.

⁷ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (nëntor 1912-janar 1914)*, përgatitur për botim nga Arkivi Qendror i Shtetit, Tiranë: “8 nëntori”, 1963, Telegram i rezervistëve në Vlorë për rezervistët në Skrapar, Vlorë, 7 dhjetor 1912; Telegram i parisë së Beratit për kryetarin e qeverisë së Vlorës, Berat, 23 dhjetor 1912; Telegram nga Janina për kryetarin e qeverisë së Vlorës, Janinë, 25 dhjetor 1912; Telegram i

banuara thajse krejtësisht prej shqiptarëve, “në çastet e para pati si pasojë largimin e disa qindrave familjeve të klasës feudale shqiptare, njerëz që e dinin mirë se në një sundim të gjatë grek jo vetëm që do të humbitnin të gjitha mundësitë për të jetuar, por edhe në rastin e një pushtimi kohëshkurtër, do të përballeshin me rreziqe të mëdha”⁸. Ato u zhvendosën më në veri, në zonën e juridiksionit të Qeverisë së Vlorës⁹. Pjesa tjetër e popullsisë nuk lëvizi.

Gjendja e krijuar në terren shqetësoi qeverinë e Vlorës, e cila e përcolli shqetësimin pranë qeverisë italiane e austro-hungareze. Në mes të dhjetorit të vitit 1912, qeveria italiane me anë të ministrit të saj në Athinë bëri një demarsh pranë qeverisë greke, për t’i tërhequr vëmendje mbi sjelljen e tyre ndaj shqiptarëve dhe panikun e krijuar në popull¹⁰. Megjithëse qeveria greke premtoi mbrojtje për popullsinë shqiptare, problemi nuk mori zgjidhje. Sjellja e ushtrisë greke veçanërisht në Çamëri vazhdoi të ishte agresive¹¹. Qëndrimin ndaj popullsisë shqiptare, qeveria greke e deklaroi edhe në takimin që ministri i Jashtëm grek pati me ministrin austro-hungarez në Athinë, në dhjetor të 1912. Sipas ministrit grek, Koromilas, zbatimi i masave ushtarake në vilajetin e Janinës ishte i nevojshëm dhe ato nuk mund të pezulloheshin ose të kufizoheshin. Sjelljen e autoriteteve greke, ai e përligji me gjendjen e luftës me Perandorinë Osmane dhe veçanërisht me operacionet ushtarake për marrjen e Janinës¹². Ndërhyrja e Italisë dhe e Austro-Hungarisë, në mbrojtje të popullsinë

prefektit të Beratit për kryetarin e qeverisë së Vlorës, Berat, 25 dhjetor 1912; Letër e Ismail Kasos nga Shkoza për kryetarin e qeverisë së Vlorës, mars 1913; *AQSh*, 145 (Qeveria e Vlorës), viti 1912, dos. II-62, fl. 19, Telegram i komandantit të garnizonit të Kuçit për kryetarin e qeverisë së Vlorës, Kuç, 9 dhjetor 1912; *AMPJ*, viti 1919, dos. 1, fl. 126-130, Listë e fshatrave të djegura nga grekët në vitet 1913-1914; *Dokumente për Çamërinë, 1912-1939*, përgatiti për botim Kaliopi Naska, Tiranë: “Dituria”, 1999, f.1-2. Telegram i komandantit të fuqisë vullnetare në Çamëri për kryetarin e qeverisë së Vlorës, Leskovik, 27 dhjetor 1912; Letër e delegatëve të Çamërisë dhe të Delvinës për Ismail Qemalin, 28 dhjetor 1912.

⁸ Eqrem Vlora, *Kujtime*, Vëllimi II, Tiranë: “Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit”, 2001, f. 38.

⁹ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: “Kristalina- KH”, 2007, f. 40.

¹⁰ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSSt.A.PA.A.*) në *AIH*, Vj. 22-9-971, Telegram nga Ministria e Jashtme e Austro-Hungarisë (nuk dihet se për kë), Vjenë, 15 dhjetor 1912.

¹¹ Hajredin Isufi, *Çamëria nëpërmjet kronikave të kohës, 1902-1940*, Tiranë: “Pegi”, 2007, f. 53-54.

¹² Greqia nuk e firmosi armëpushimin me Perandorinë Osmane më 2 dhjetor të vitit 1912. Ndryshe nga aleatët e saj ballkanike, ajo vazhdoi luftën me Perandorinë Osmane. Një nga arsytet e këtij akti ishte dëshira për ta marrë me luftë kështjellën e Janinës, e cila mbahej e rrethuar që nga dyjavëshi i dytë i nëntorit 1912. Kështjella e Janinës u mor nga trupat greke, më 6 mars 1913, pas një rrethimi disa mujor.

çame, për të ishte e pavend. Format e reagimit ndaj pushtimit grek konsideroheshin prej diplomatit grek si “akte të turpshme që kjo popullsi (nënkupto popullsinë shqiptare. L. D.) i kishte bërë popullsisë greke”¹³.

E ndërsa ushtria greke i ishte drejtuar qytetit të Gjirokastrës, në rrethet e politikës greke, sërish u shtrua për diskutim çështja e zgjerimit të pushtimit deri në Vlorë¹⁴. Duket se për të kishte një përplasje mendimesh midis kryeministrit, Venizellos dhe mbretit të porsazgjedhur, Kostandin, njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i ushtrisë greke. Në telegramin e datës 18 mars 1913 që Venizellosi i dërgoi këtij të fundit, udhëzoi se ishte e nevojshme të pushtohej krejt “Epiri”, brenda kufijve të caktuar nga memorandum i grek i 3 janarit 1913. Ushtria greke, në asnjë mënyrë nuk duhej t’i tejkalonte pretendimet e memorandumit dhe për asnjë arsye nuk duhej t’i drejtohej Vlorës, ose të krijonte dyshime se synonte të pushtonte qytetin¹⁵. Por, mbreti dhe opozita greke mendonin ndryshe. Ata ende i qëndronin mendimit të disa muajve më parë për të pushtuar Vlorën. Këtë veprim ata vazhdonin ta përligjinin me faktin se Vlora duhej përdorur nga Greqia si koncesion për të zotëruar territoret që tashmë ajo i kishte pushtuar. Drejtori i Zyrës Shqiptare në Ministrinë e Jashtme Greke njëkohësisht edhe këshilltar politik i komandantit të ushtrisë së Epirit, Sahturis, këmbëngulte në ndërmarrjen e një hapi të tillë. Në qëndrimet e tij ai mbështetej nga kolegu, Dragumis, njohës edhe ai i çështjes shqiptare dhe ambasadori i ardhshëm i Greqisë në Rusi. Mendimet dhe qëndrimet e tij, ai i shprehu edhe në letrën dërguar komandantit të ushtrisë greke në Himarë, Spiromilo. Në të ai shfaq hapur kundërshtimin ndaj politikës së ndjekur nga Venizellosi për të ashtuquajturën çështje të Epirit, duke i rekomanduar mikut të tij të pushtonte qytetin. Spiromilo megjithëse e mbështeste pushtimin, nuk ishte i gatshëm të vepronte për mungesë forcash¹⁶.

¹³ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-9-975, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Athinë për ministrin e Jashtëm, Athinë, 22 dhjetor 1912.

¹⁴ Në rrethet zyrtare greke, çështja e pushtimit të Vlorës ishte ngritur që në fillim të nëntorit 1912. Fillimisht, kryeministri grek, Venizellos kishte rënë dakord ta pushtonte qytetin, por shumë shpejt ndërroi mendim. Arsyeja lidhej me frikën që ai kishte nga Italia. Duke e konsideruar Italinë, armikun më të madh të “racës greke”, ai mendonte se pushtimi i Vlorës do t’i jepte shkas një sulmi italian. Në gjendjen e ndërlikuar në të cilën ndodhej Greqia për shkak të ftohjes me Austro-Hungarinë dhe fërkimeve me Bullgarinë, Venizellosi nuk guxonte t’i shtonte vetes edhe armiqësinë e hapur me Italinë. Tërheqja nga pushtimi i Vlorës u zëvendësua me orientimin dhe më vonë me vendimin për të zbarkuar në Sarandë. Për më shumë shih: L. Dushku, *art. i cit.*, f. 60-62.

¹⁵ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-18-1839. Telegram i Venizellosit për Komandantin e Përgjithshëm të ushtrisë greke, Athinë, 18 mars 1913.

¹⁶ Milto Spyromelios, *Ελλάς και Αλβανία*, Kajro: 1942 (Shfrytëzuar materiali në: *AIH*, A-IV-213, Milto Spiromilo, “Greqia dhe Shqipëria”, fl. 45).

Mendoj se kishte dy arsye që e bënin qeverinë greke të ishte e kujdesshme në lidhje me pushtimin e Vlorës, duke mos marrë parasysh mendimin e mbretit dhe presionin e opozitës.

Arsyeja e parë lidhet me frikën që qeveria greke vazhdonte të kishte nga një ndërhyrje e mundshme italiane. Për arsye ushtarake dhe sigurie, Italia e mbështetur nga Austro-Hungaria kundërshtonte fort zotërimin nga Greqia të brigjeve përballë Korfuzit. Ajo i trembej faktit se zona në fjalë mund të shndërrohej në një bazë ushtarake greke, që do të kontrollonte kësaj hyrjen në Adriatik¹⁷. Më 18 mars 1913, ambasadori italian në Athinë i përcolli qeverisë greke telegramin e qeverisë së tij, i cili pasi e vinte në dijeni për informacionin që Ministria e Jashtme italiane kishte marrë mbi një pushtim të mundshëm të Vlorës, e sinjalizonte atë se Italia nuk do ta toleronte një veprim të tillë¹⁸. I njëjti qëndrim iu transmetua edhe Theotoki-t, të dërguarit grek që kishte mbërritur në Romë për të njoftuar hipjen në fron të mbretit Kostandin. Në raportin që ai i dërgoi kryeministrit Venizellos evidentonte se “San Xhuliano u duk absolutisht anti grek dhe absolutisht intransigjent në çështjen e bregdetit epirotik. Italia dhe Austro-Hungaria e karakterizojnë të rrezikshëm posedimin e bregdetit dhe të ngushticës së Korfuzit nga ana e Greqisë. Intransigjent mbetet San Xhuliano edhe për kufijtë e brendshëm të Epirit”¹⁹.

Marrëdhëniet mes Italisë dhe Greqisë mbetën të acaruar gjatë gjithë pranverës së vitit 1913. Në fillim të majit 1913, Roma përsëri i bëri me dije Athinës se nuk do të lejonte kurrësi që Greqia të kontrollonte të dy anën e ngushticës së Korfuzit, madje ajo ishte e gatshme ta pengonte atë edhe me luftë. Pas korrespondencës italiane, shqetësimi në qeverinë greke u rrit. Ministri i Greqisë në Gjermani në takimin që zhvilloi me homologun britanik dhe francez atje, transmetoi frymën shqetësuese që mbizotëronte në qeverinë e tij. Britania e Madhe dhe Franca i rekomanduan Greqisë, evitimin e çdo veprimi që mund të shkaktonte konflikt të armatosur me Italinë²⁰. Në një situatë të tillë, qeveria greke jo vetëm që nuk mund të diskutonte pushtimin e Vlorës, por duhej të përgatitej për “lëshime” të tjera në zonën e pretenduar të bregdetit shqiptar.

Arsyeja e dytë lidhet me ecurinë e çështjes së kufirit verior të Shqipërisë. Serbia dhe Mali i Zi gjatë Luftës së Parë Ballkanike kishin pushtuar një sërë terrioresh shqiptare. Në mbështetje të bisedimeve serbo-greke të nëntorit të

¹⁷ *AIH*, A-IV-76, Tomas Ippen, “Si u krijuan kufijtë e Shqipërisë”, fl. 37-40.

¹⁸ Basil Papadakis, *Histoire diplomatique de la question Nord-Epirote (1912-1957)*, Athènes: “Imprimerie J. Alevropoulos”, 1958, f. 13.

¹⁹ George Ventiris, *Ελλάς τού 1910-1920*, Vol. 2, Athens, 1929 (shfrytëzuar materiali në *AIH*, A-VI-36, Ventiris Jorgji, “Greqia nga viti 1910-1920”, fl.1-2).

²⁰ *British documents on the Origin of the War, 1898-1914*, Vol. 10, Part I, London: “G. P. Gooch and H. Temperley”, 1926-1930, Telegram i ministrit të Britanisë së Madhe në Berlin, për Greyt, Berlin: 4 maj 1913.

1912²¹, qeveria greke ndihmoi ushtarakisht jo vetëm Serbinë, por edhe Malin e Zi për pushtimin dhe mbajtjen sa më gjatë të qyteteve bregdetare shqiptare. Në ndihmë të ushtrive serbe dhe malazeze, anijet greke transportuan trupa dhe municion lufte, kryesisht drejt Shkodrës²². Greqia pretendonte ta përdorte zotërimin e qyteti verior shqiptar nga Malit të Zi, si “precedent pozitiv në dobi të interesave helene në Epir”²³. Por, pavarësisht faktit se qytetet ishin pushtuar, vendimi i Fuqive të Mëdha në Konferencën e Londrës detyroi si Serbinë ashtu dhe Malin e Zi të tërhiqeshin nga territoret shqiptare. Ky zhvillim e detyroi Venizellosin të reflektonte për zgjerimin e pushtimeve në territoret shqiptare. Në momentin kur Evropa kishte rënë në ujdë për të përzënë Serbinë nga Durrësi dhe Malin e Zi nga Shkodra, nuk kishte arsye të mos e bënte këtë edhe me Greqinë. Në takimin që kryeministri grek zhvilloi me ministrin britanik në Athinë, i vuri në dukje pozitën e vështirë në të cilën ai ndodhej. Nga acarimi i marrëdhënieve me Fuqitë e Mëdha dhe shpërthimi i një lufte të përgjithshme, Fuqitë e Vogla ballkanike, do ta pësonin më tepër²⁴. Në këtë situatë, Venizellosi vendosi që Vlora të mos pushtohej, por me Megali Idenë në mendje, vazhdoi rezistencën për të përfituar territoret shqiptare që kishte kërkuar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

Diplomacia greke në veprim

Takimet e zyrtarëve grekë me përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha dhe kancelaritë diplomatike ndërkombëtare, në kohën e diskutimit të kufirit shqiptaro-grek në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (19 mars-11 gusht

²¹ Në bisedime Greqia ra dakord t’i ndante territoret shqiptare mes saj dhe Serbisë dhe të mbështeste pretendimet serbe për daljen në det nga Lezha deri në Durrës. Mbështetja greke do të jepej jo vetëm në rrugë diplomatike, por edhe me forcë të armatosur. Shih: L.S. Stavrianos, *The Balkans since 1453*, Holt, Rinehart and Wiston, 1958, f. 510; Zekeria Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2006, f. 317.

²² *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 23-25-2531, Telegram i ministrit të Austro-Hungarisë në Cetinë për Ministrinë e Jashtme, Cetinë, 31 mars 1913; *po aty*, Vj. 23-25-2533, Raport i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë për ministrin e Jashtëm, Bertold, Vjenë, 31 mars 1913; *po aty*, Vj. 23-25-2531, Telegram i ministrit të Austro-Hungarisë në Londër për Bertoldin, Londër, 2 prill 1913, *British documents...*, Vol. 10, Pjesa I, Telegram i ministrit të Britanisë së Madhe në Beograd për ministrin e Jashtëm britanik, Beograd, 8 prill 1913.

²³ *AQSh*, Fondi 1501/3 (Koleksion dokumentesh nga arkivi i Ministrisë së Jashtme të Italisë), viti 1913, dos. 71, fl. 8-9, Raport i Ambasadës së Italisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 24 prill 1913.

²⁴ *British documents...*, Vol. 10, Pjesa I, Telegram i ministrit të Britanisë në Athinë për ministrin e Jashtëm, Grey, Athinë, 6 prill, 1913.

1913), manifestojnë një këmbëngulje të vazhdueshme për të zotëruar territoret e pushtuara në Shqipërinë Jugore.

Mendoj se këmbëngulja greke ishte e fortë për dy arsye.

Së pari, Greqia pretendonte se ishte palë në çështjen e caktimit të kufirit me Shqipërinë, për sa kohë ajo ishte në luftë me Perandorinë Osmane. Por, ky pretendim qëndroi deri më 30 maj të 1913, kohë kur pas shumë hezitimesh Greqia së bashku me fuqitë e tjera ballkanike, firmosën Traktatin e Paqes me Perandorinë Osmane. Mbështetur në të, palët nënshkruese pranuan t'ua besonin Fuqive të Mëdha kujdesin për të rregulluar kufijtë dhe çdo çështje tjetër që kishte të bënte me Shqipërinë²⁵. Në këtë mënyrë që nga 30 maji i vitit 1913, Greqia dhe shtetet e tjera ballkanike nuk kishin më shpresa për të qenë palë në çështjen e caktimit të kufirit me Shqipërinë. Traktati i Paqes midis Perandorisë Osmane dhe shteteve të Ballkanit, është akti i parë ndërkombëtar në të cilin shtetet fqinje ballkanike, ndonëse në mënyrë të tërthortë, pranuan pavarësinë e Shqipërisë.

Arsyeja e dytë ka të bëjë me qëndrimet e ndryshme që Fuqitë e Mëdha mbanin ndaj kufirit shqiptaro-grek dhe tërheqjes së ushtrisë greke prej territoreve të pushtuara në Shqipërinë e Jugut. Fuqitë e Antantës, sidomos Franca dhe Rusia, në mënyrë të vazhdueshme dhe intensive përkrahnin zellshëm pretendimet greke. Ata pretendonin ta mbanin Greqinë të lidhur pas Antantës. Që më 15 dhjetor 1912, ministri i Jashtëm francez, Poincaré kishte udhëzuar ambasadorin Cambon të mbronte vijën e kufirit, që fillonte nga bregu perëndimor i liqenit të Ohrit dhe shkonte në vijë të drejtë për në Jug, mbi Delvinë dhe më pas në drejtim të detit²⁶. Kjo vijë, me përjashtim të Himarës, rezultoi se ishte e njëjtë me vijën e memorandumit që Greqia i paraqiti Konferencës së Londrës. Gjatë negociatave për kufirin jugor të shtetit shqiptar, Franca u përpoq ta zvarriste sa më shumë zgjidhjen përfundimtare të tij. Ajo kërkoi t'i ngushtonte sa të qe e mundur kufijtë e Shqipërisë dhe të siguronte nga Austro-Hungaria dhe Italia sa më shumë lëshime për Greqinë²⁷. Britania e Madhe përpiquej të ishte neutrale dhe të ruante ekuilibrin mes dy Blloqeve²⁸. Roli i saj, sipas ministrit të jashtëm Grey "qëndronte vetëm në gjetjen e një rruge të mundshme për të lehtësuar gjendjen e përgjithshme dhe për të shpëtuar paqen..."²⁹. Nën një qëllim të tillë, ministri britanik punoi i vendosur për të

²⁵ AMPJ, Fondi Shtesë, dos. II, fl. 1-3, Traktati i Paqes mes Perandorisë Osmane dhe shteteve ballkanike (Greqi, Bullgari, Serbi dhe Mali i Zi), Londër, 30 maj 1913.

²⁶ *Po aty*, viti 1945, dos. 20, fl. 16-41. La questione del "L'Epiro del Nord" dal punto di vista diplomatico.

²⁷ V. Duka, *vep. e përm.*, f. 36.

²⁸ Barbara Jelavich, *History of the Balkans, twentieth Century*, Volume 2, "Cambridge University Press", 1994, f. 101.

²⁹ Edward Grey, *Memories de Edward Grey*, Paris: "Payot", 1927, f. 253.

gjetur një kompromis midis interesave të grekëve dhe italianëve, në çështjen e kufirit jugor të Shqipërisë. Këtë ai synoi ta realizonte duke e lidhur çështjen e kufirit jugor shqiptar me atë të ishujve të Egjeut, dy çështje këto që kishin të bënin direkt me Italinë dhe me Greqinë. Mbajtja e ishujve të Egjeut nga ana e Italisë, i shërbente forcimit të saj, gjë kjo që në Londër gjykohej të ishte e palejueshme³⁰. Në këto përpjekje Grey u mbështet nga kryeministri francez, Pichon³¹. Duke e marrë pushtimin e Shqipërisë së Jugut një fakt të mirëqenë dhe duke dashur të shmangnin përsëritjen nga Greqia, të kokëfortësisë malazeze për të mos u tërhequr nga Shkodra, Fuqitë e Antantës linin të kuptohej se nuk ja kishte ënda që të përdorej forca për ta larguar ushtrinë greke prej territoreve shqiptare që ajo kishte pushtuar³².

Fuqitë e Trepalëshit megjithëse nuk i mbështesnin kërkesat greke, nuk manifestonin për çështjen e kufirit jugor shqiptar, unanimitetin që kishin pas në caktimin e kufijve veriorë të Shqipërisë. Qëndrimin unik e prishte Gjermania³³. Lidhjet dinastive që ajo kishte me Greqinë³⁴ dhe planet e Berlinit për ta tërhequr Greqinë nga orbita e Antantës e për ta bashkuar me Aleancën Trepalëshe, ndikonin në qëndrimin e saj. Kajzeri gjerman vazhdonte të mendonte se projektet e mësipërme mund të realizoheshin, vetëm duke sakrifikuar krahinat jugore shqiptare³⁵.

Qoftë për pozicionin gjeopolitik të Greqisë apo për sharmin që ushtronte historia dhe kultura e lashtë greke, Fuqitë evropiane tregonin një mirëkuptim e tolerancë jo të zakonshme karshi kapriçove të politikës së Athinës³⁶. Favorizuese për Greqinë ishte edhe padituria e opinionit publik evropian në lidhje me kombësinë shqiptare. Në përgjithësi, Fuqitë e Mëdha ishin indiferente për mirëqenien e shtetit të porsakrijuar shqiptar. Për to, ai ishte krijua për

³⁰ Arben Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha*, Tiranë: "8 nëntori", 1978, f. 554.

³¹ Edith Stickney, *Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet evropiane ndërkombëtare, 1912-1923*, Tiranë: "Koha", 1998, f. 55.

³² *British documents...*, Vol. 10, Pjesa I, Telegram i Grey-t për ministrin britanik në Paris, Londër, 17 prill 1913; Telegram i Grey-t për ministrin britanik në Romë, Londër, 7 maj 1913; Telegram i Grey-t për ministrin britanik në Rusi, Londër, 15 maj 1913.

³³ Prince Lichnowsky, *My mission to London, 1912-1914*, f. 4, 6-7 në: <http://www.gwpda.org/1914m/lichnowy.html> data e klikuar, tetor 2008.

³⁴ Kajzeri i Gjermanisë e kishte kumat mbretin e Greqisë.

³⁵ A. Puto, *vep. e përm.*, f. 236.

³⁶ Pëllumbi Xhufi, "Megali-Idea" dhe pasqyrimet e saj në marrëdhëniet shqiptaro-greke", në *Studime historike*, Nr. 1-2, Tiranë, 2006, f. 26.

leverdi jo me dëshirë, dhe interesat e tij jetike mund të sakrifkoheshin në dobi të ruajtjes së paqes në botë³⁷.

Qëndrimet e mësipërme, Greqia i gjykoi të ishin në favor të saj. Ajo në vazhdimësi deklaroi se nuk do t'i braktiste territoret e pushtuara në Shqipërinë e Jugut dhe se do t'i nënshtrohej vetëm rezultatit të një plebishiti në krahinat e rivendikuara prej saj³⁸. Më 8 prill 1913, ministri i Jashtëm britanik në marrëveshje me homologun e tij francez, duke dashur të bashkonte pikëpamjet e kundërta që Fuqitë e dy Blloqeve kishin në lidhje me kufirin shqiptaro-grek, propozoi dërgimin në vend të një komisioni ndërkombëtar, i cili do të ngarkohej të caktonte vijën e kufirit "në përputhje me karakterin etnik të popullsisë"³⁹. Ky propozim shkante edhe në mbështetje të idesë greke, të ekspozuar disa ditë më parë për organizimin e një plebishiti. Por, Italia kundërshtoi. Më 21 maj 1913, ajo i dorëzoi Konferencës një projekt me një përshkrim të hollësishëm të kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë. Projekti italian që në vija të përgjithshme përputhet me kufirin e sotëm shqiptaro-grek, linte Korçën dhe Gjirokastrën brenda Shqipërisë, por i bënte një lëshim Greqisë në zonën bregdetare, duke përcaktuar si pikë kufitare, kepin e Stillos⁴⁰. Nëse Greqia pranonte vijën e mësipërme, Italia premti se do të rishikonte qëndrimin e saj në lidhje me çështjen e ishujve të Dodekanezit në Egje⁴¹. Por, Greqia vazhdoi të ishte kryeneçe. Më 24 maj 1913, Venizellosi njoftoi ministrin e Jashtëm të Britanisë së Madhe, Grey-in, se Greqia ishte e vendosur të mos i tërhiqte trupat nga tokat e pushtuara. Ajo vazhdoi të insistonte mbi idenë e plebishitit nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, si mjeti i vetëm që i jepte popullsisë së Shqipërisë së Jugut të drejtën për të shprehur fjalën e saj⁴².

Rëndësia që territoret e pushtuara kishin për Greqinë, u deklarua edhe në takimin që ministri grek në Londër zhvilloi në fillim të qershorit 1913, me ministrin e Jashtëm, Grey. Në vazhdimësi të këmbënguljes greke për të zotëruar territoret shqiptare, diplomati grek deklaroi se qeveria e tij do të vazhdonte ta

³⁷ Joseph Swire, *Shqipëria: Ngritja e një Mbretërie*, Tiranë: "Dituria", 2005, f. 130.

³⁸ *Ministere des Affaires Etrangères, Archives Diplomatiques* (më tej: *AMAE*) në *AIH*, Fondi 182, fl. 855, 862, Telegram i qeverisë greke për Ministrinë e Jashtme të Francës, 31 mars 1913; Raport i ministrit të Francës në Londër për Ministrinë e Jashtme, Londër, 2 prill 1913.

³⁹ A. Puto, *vep. e përm.*, f. 241.

⁴⁰ *British documents...*, Vol.10, Pjesa I, Raport i Grey-t për ministrin britanik në Austro-Hungari, Londër, 30 maj 1913.

⁴¹ Ph. Philon, *The question of Northern Epirus: It's historical and diplomatic background*, Washington: 1945, f. 8.

⁴² B. Papadakis, *vep. e përm.*, f. 15.

ruante pushtimin atje⁴³. Ndonëse mbështeti idenë e Grey-t për përcaktimin e kufirit me Shqipërinë nga një komision ndërkombëtar, ai pranoi si kriter të vetëm të punës së tij, ndërgjegjen e popullsisë. Sipas tij, në rast se popullsia greke “lihej nën sundimin shqiptar”, pakënaqësitë e saj do të ishin të vazhdueshme, duke lënë të nënkuptuar një reagim të mundshëm të saj.

Deri në mes të qershorit 1913, diplomacia greke kishte mundur ta zvarriste çështjen e kufirit me Shqipërinë, pa hequr dorë nga pretendimet e saj të fillim vitit. Në atë situatë, ministri i Jashtëm britanik rivlerësoi si të vetmen zgjidhje për të dalë nga kriza, kombinimin e çështjes së kufirit shqiptaro-grek me atë të ishujve të Egjeut. Ishujt e Egjeut u konsideruan kështu, një kompensim i mundshëm që i afrohej Greqisë, për mospranimin që Fuqitë e Aleancës Trepalëshe i bënë kërkesave të saj në territoret jugore shqiptare⁴⁴. Kushti i domosdoshëm i marrëveshjes ishte që Korça në brendësi dhe kepi i Stillos në bregdet të përfshiheshin në kufijtë e ardhshëm të Shqipërisë⁴⁵. Po në të njëjtën kohë, Grey ri hodhi në diskutim, idenë e tij për një komision ndërkombëtar për caktimin në terren të kufirit shqiptaro-grek, me dy pika ekstreme: Korça dhe Stillosi. Nën këshillën e Francës, më 17 qershor 1913, Greqia lëshoi pe dhe pranoi kepin e Stillos si pikë jugore bregdetare me Shqipërinë. Seanca e mbajtur një dite më pas, më 18 qershor, solli marrëveshjen për të. Kepi i Stillos u pranua nga të gjitha Fuqitë si pikë e daljes së kufirit shqiptaro-grek, në zonën bregdetare. U hodh kështu, hapi i parë drejt përcaktimit të kufirit shqiptaro-grek. Mbeti pa u zgjidhur kufiri në krahinat e brendshme, i cili pësoi zvarritje për shkak të fillimit në fund të qershorit 1913, të Luftës së Dytë Ballkanike. Në vija të përgjithshme, ajo pjesë e kufirit shqiptaro-grek mori zgjidhje më 11 gusht 1913, me vendimin përfundimtar të Konferencës së Ambasadorëve. Mbështetur në të, Korça dhe brigjet në Perëndim dhe Jug të liqenit të Ohrit i paracaktoheshin Shqipërisë. Fati i Gjirokastrës ishte i diskutueshëm. Qyteti vazhdoi të mbetej me status të papërcaktuar. Çështja e kufirit mes Shqipërisë e Greqisë u zgjidh kështu nëpërmjet një kompromisi të pranueshëm, edhe pse jo krejtësisht të kënaqshëm për Fuqitë që e kishin arritur atë. Bashkimi i Korçës dhe i kepit të Stillos-it me Shqipërinë arriti të merrte pëlqimin e të gjitha Fuqive të Mëdha vetëm mbi bazën e një akordi arritur mes tyre, sipas të cilit, ishujt e Egjeut me përjashtim të Imbros dhe Tonedos, duhej t’i jepeshin Greqisë⁴⁶. Që nga ajo kohë u krijua

⁴³ *British documents...*, Vol. 10, Pjesa II, Telegram i Grey-t për ministrin britanik në Athinë, Londër, 4 qershor 1913.

⁴⁴ E. Stickney, *vep. e përm.*, f. 57-58.

⁴⁵ *AIH*, A-VI-39, fl. 96, Telegram i Greyt për ministrin britanik në Vjenë, Londër, 27 dhjetor 1913.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 79-81, Propozimet e ministrit të Jashtëm të Britanisë së Madhe, Grey për Fuqitë e Mëdha, Londër, 12 dhjetor 1913.

nga diplomacia greke dhe u përdor nga grekët konotacioni “Epir i Veriut”, kufijtë gjeografikë të të cilit përfshinin të gjithë zonën pushtuar nga ushtria greke në Jug të vijës Korçë-Himarë. Popullsia shqiptare që banonte aty, si dhe frekuentonte besimin ortodoks u përcaktua si vorioepirote.

Në mbështetje të pretendimeve të saj, qeveria greke ushtroi presion të vazhdueshëm dhe këmbënguli në ambiciet e saj për të zotëruar krejt territoret shqiptare që kishte pushtuar. Krahas aktivitetit të ngjeshur diplomatik pranë kancelarive të Fuqive të Mëdha, veçanërisht asaj britanike⁴⁷, vëmendja e politikës greke u përqendrua tek territoret e pushtuara në Shqipërinë e Jugut. “Miradministrimi” i tyre merrte rëndësi të veçantë për faktin se një reagim pro grek i popullsisë atje, përforconte karakterin grek të krahinës në fjalë dhe ekzistencën e “çështjes së Vorio-Epirit”. Ekzistenca e kësaj çështjeje jo vetëm legjitimonte pretendimet greke aty, duke shërbyer si mburojë ndaj presionit të Italisë e Austro-Hungarisë, por edhe lehtësonte mbrojtjen që veçanërisht Franca i bënte çështjes greke. Në këtë mënyrë vëmendja ndërkombëtare zhvendosej nga çështja e kufirit shqiptaro-grek, në të ashtuquajturën çështje vorioepirote. Nga ana tjetër qeveria e Athinës synoi ta përdorte pushtimin e territoreve shqiptare, si mjet presioni te Fuqitë e Mëdha edhe për të siguruar përfitime në çështjen e ishujve të Egjeut. Kjo çështje konsiderohej të ishte e vështirë për të, veçanërisht pas kundërshtimeve të forta që Perandoria Osmane i bënte lëshimit të tyre, duke e bërë të qartë se mund të shkonte edhe në luftë⁴⁸.

Administrimi i territoreve të pushtuara në Shqipërinë Jugore

Masa e parë që qeveria greke mori në territoret e pushtuara të Shqipërisë së Jugut lidhej me riorganizimin administrativ dhe vendosjen e tyre në një kuadër ligjor, të ngjashëm me atë që ekzistonte në Greqi. Fillimisht territoret e pushtuara u administruan nga dy administrata të veçanta. Territoret juglindore shqiptare u bënë pjesë e Administratës së Përgjithshme të Maqedonisë. Më 10 shkurt 1913, qeveria greke emëroi në postin e guvernatorit politik në Korçë, ish konsullin grek të Gjirokastrës, Petro Kapsambelis dhe në atë të komandantit ushtarak majorin arvanitas, Kondulis. Në maj të po atij viti, pas largimit të Kapsambelis-it, administrimi politik iu ngarkua Kondulis-it. Territoret e poshtme shqiptare u përfshinë në Administratën e Përgjithshme të Epirit, e organizuar në nëntë prefektura: atë të Janinës, Prevezës, Thesprotisë, Gjirokastrës, Himarës, Sarandës, Leskovikut, Përmetit dhe Delvinës. Më 29

⁴⁷ Michael Llewellyn Smith, “Venizelo’s diplomacy, 1910-1913”, në *Eleftheros Venizelos: The trials of Statesmanship*, editor Paskalis Kitromilides, “Edinburgh University”, 2006, f. 151.

⁴⁸ N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Peace Conference of Paris, 1919*, Thessalonica: “Institute for Balkan Studies”, 1978, f. 30.

mars 1913, guvernatori civil i Janinës, Jorgos Zografosi u emërua Komandant i Përgjithshëm i kësaj administrate. Ai ishte djali i bankierit të njohur nga Qesarati i Gjirokastrës, Kristaq Zografos. Kishte studiuar drejtësi në Universitetin e Parisit dhe të Mynihut. Në vitin 1905 ishte zgjedhur deputet në parlamentin grek dhe në vitin 1909 ishte emëruar ministër i Jashtëm i Greqisë në qeverinë e kryeministrit Dimitrios Rallis. Ai njihej si bashkëpunëtor i ngushtë i Venizellosit⁴⁹, njeri me kulturë të gjerë, por “idealist dhe fanatik i Megali Idesë”⁵⁰. Shprehte hapur fobinë e tij ndaj shqiptarëve dhe mendonte se Austro-Hungaria i kishte hyrë një rrugë të gabuar duke krijuar një “Shqipëri të pavarur që do të përfshinte në të edhe Epirin me Gjirokastrën”⁵¹.

Në të gjitha viset e Shqipërisë së Poshtme, të pushtuara nga ushtria greke, veproi rregullorja ushtarake për vendet e pushtuara. Administrimi i territoreve të pushtuara u bë me anën e proklamave dhe qarkoreve të mbretit të Greqisë, njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i ushtrisë greke⁵². Dy proklamatat e para dolën më 21 shkurt 1913. Proklamata e parë likuidoi autoritetet politike dhe ushtarake qendrore të deriatëhershme, duke shkëputur kështu lidhjet e territoreve të pushtuara me Stambollin. Deri në lëshimin e një vendimi të ri u njohën vetëm autoritetet politike e fetare lokale. Autoritetet politike lokale u vunë direkt nën ndikimin e autoriteteve të larta greke të pushtimit, prej të cilave do të merrnin urdhrat në vazhdimësi. Ajo që vihet re në të dy administratat është fakti se shumë shpejt, raporti mes nëpunësve lokalë ekzistues dhe atyre të punësuar rishtazi, ndryshoi në favor të këtyre të fundit. Në administratat lokale u punësuan nëpunës nga sektorë të ndryshëm të shtetit grek dhe “epirotë” me përvojë nga e kaluara, të cilët shfaqnin besim dhe dëshirë për bashkëpunim. Shpejt, shqiptarët e panë veten jashtë administratave lokale dhe u vunë nën diktatin e të porsaardhurve. Shpejt u larguan nga administrata e Maqedonisë, edhe grekomanët. Nëpunës lokalë dhe drejtues të shkollave greke në Korçë mbetën kryesisht grekët e ardhur nga Greqia⁵³.

Proklamata e dytë shpalli veprimin e ligjit ushtarak në territoret e pushtuara. Pavarësisht se i jepte të gjithë popullsisë, garanci për sigurinë e jetës, të nderit dhe të pasurisë, ligji dënonte “në mënyrë shembullore” ata që i kundërviheshin urdhrave të administratës ushtarake, ligjeve të Greqisë dhe që tentonin të prishnin rendin publik⁵⁴.

⁴⁹ *Po aty*, f. 27.

⁵⁰ Karl Buchberger, “Vjetët e mija në Shqipëri”, në *Studime historike*, nr. 4, Tiranë: 1972, f. 148.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² Ioanis Kyrochistos, *A concise History of the Balkan Wars, 1912-1913* (by Army History Directorate, Greece), Hellenic Army Staff, 1998, f. 129-131.

⁵³ Nikollaq Zoi, *Një faqe historie*, Korçë: “Kotti”, 2000, f. 63.

⁵⁴ *AIH*, A-IV-451, *burim i cit.*

Ndryshe ndodhi me çështjet civile, tregtare, administrative dhe ekonomike. Ligji i posaçëm grek i 14 marsit të vitit 1913, la në fuqi legjislacionin ekzistues osman⁵⁵. Mbështetur në të, autoriteti i komuniteteve fetare vazhdoi të ishte i fortë. Lënia në fuqi e legjislacionit osman, diskriminonte shqiptarët. Kombësia shqiptare nuk njihej, si rrjedhim ndalohej dhe dënohej përdorimi i gjuhës shqipe dhe hapja e shkollave në atë gjuhë. Ligjërisht lejohej vetëm përdorimi i gjuhës greke dhe turke. Shqiptarët duhet të vazhdonin të frekuentonin ose shkollat greke ose ato turke, të cilat funksiononin në të gjitha rajonet ku kishte popullsi shqiptare myslimane. Përjashtim bënin vetëm ligjet që kishin të bënin me sigurimin publik që binin në kundërshtim me ligjet greke. Në këto raste vihej direkt në fuqi ligji grek. Në këtë mënyrë autoritetet greke të pushtimit e kishin të përligjur qëndrimin që do të duhet të mbanin ndaj atyre që e kundërshtonin. Në këtë rast bëhej fjalë kryesisht për shqiptarët, të cilët kishin filluar t'i hapnin probleme administratës së pushtimit. Përpilimi dhe zbatimi i legjislacionit të mësipërme, tregonte qartë qëllimet afatgjata që Greqia kishte ndaj territoreve shqiptare. E rëndësishme për të ishte “inkorporomi i vendeve të pushtuara me trungun kombëtar grek”⁵⁶. Të dyja administratat megjithëse vepruan si dy njësi autonome, u vunë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të zyrtarëve dhe ligjeve greke, të cilët vepronin në dobi të çështjes greke, mbështetur në direktivat e qeverisë së Athinës.

Administratat qëndruan të ndara deri më 8 nëntor 1913. Pas kësaj date, përgjegjësinë për administratën e Maqedonisë e mori Administrata e Përgjithshme e Epirit. Administrator dhe komandant i Administratës së Përgjithshme të Epirit të bashkuar mbeti Jorgos Zografos. Nën frymën e Traktatit të Athinës, i nënshkruar më 14 nëntor 1913 mes Greqisë dhe Perandorisë Osmane, qeveria greke përshtati sërish legjislacionin⁵⁷. Më 29 nëntor 1913, me një akt nënligjor ndërsa konfirmoi lënien në fuqi të ligjit të 14 marsit të 1913, autorizoi autoritetet ushtarake që të zbatonin me Dekrete Mbretërore, pjesërisht ose tërësisht ligjet greke⁵⁸. Ligjet dhe aktet nënligjore greke do të vepronin në të gjithë zonën e pushtuar pavarësisht vendimit të Fuqive të Mëdha për kufirin shqiptaro-grek. Në këtë mënyrë, Greqia vazhdoi t'i konsideronte të gjitha territoret e poshtme shqiptare, si pjesë që duhej t'i bashkoheshin shtetit grek.

Pas plotësimit të kuadrit ligjor, vëmendja e autoriteteve të pushtimit u përqendrua në “bindjen” e popullatës së krahinave të pushtuara, për të manifestuar dëshirën e tyre për bashkim me Greqinë”. Propaganda kishte pak

⁵⁵ *Po aty*, A-IV-330, Timo Dilo, “Invazionet greke në Shqipërinë e Jugut”.

⁵⁶ *Po aty*, A-IV-451, *burim i cit.*

⁵⁷ Renee Hirschon, *Crossing the Aegean: An Appraisal of the 1923 Compulsory Population Exchange between Greece and Turkey*, “Berghahn Books”, 2003, f. 112.

⁵⁸ *AIH*, A-IV-451, *burim i cit.*

gjasa të mos gjente terren. Popullsia e krishterë shqiptare kishte qenë gjithmonë nën ndikimin e kishës, të shkollës dhe tregjeve ekonomike greke. Në kushtet kur autoriteti i shtetit të porsakrijuar shqiptar nuk arrinte tek ta dhe presioni i administratës greke ishte i dukshëm, mundësia që ajo të joshej dhe të mbështeste propagandën greke, ishte më e madhe. Pavarësisht se nga përkatësia etnike, popullsia shqiptare e dallonte veten nga ajo greke “nëse pavarësia e Shqipërisë nuk sigurohej, një pjesë e saj parapëlqente të ishte pjesë e Greqisë. Me grekët ata i bashkonte gjuha, të cilën pothuajse të gjithë në jug e flisnin rrjedhshëm, kultura e përbashkët shpirtërore dhe interesat ekonomike”⁵⁹. Këto konstatime ishin relative dhe jo gjithmonë i përshtateshin gjendjes reale në Jug të Shqipërisë.

Autoritetet e pushtimit u ndihmuan në punën e tyre nga priftërinjtë, mësuesit e shkollave greke, popullsia greke që banonte në Shqipërinë e Jugut, grekomanët dhe shtypi grek. Së bashku ata zhvilluan një propagandë të gjallë për t’i bindur ose detyruar shqiptarët të dërgonin fëmijët në shkollat greke dhe të manifestonin në favor të Greqisë⁶⁰. Një valë mitingjesh pro greke shpërtheu në zonat e pushtuara. Mitingjet u organizuan me madhështi të madhe duke u paraqitur si manifestime spontane të popullsisë vendase që ndjehej greke dhe kërkonte bashkim me Greqinë⁶¹. Në mbrojtje të kauzës greke, ndaj popullsisë filloi edhe përgatitja psikologjike për përdorimin e mjeteve të forcës në rast nevojë. Peticione nga Gjirokastra, Himara e Korça, të firmosura edhe nga klerikë të kishës ortodokse, mbërritën pranë Konferencës së Ambasadorëve në Londër⁶². Tekstet e tyre shkonin në mbështetje të politikës greke dhe qëndrimeve që ajo mbante në Konferencën e Ambasadorëve për zonat e pushtuara, të cilat për të ishin “greke nga feja, nga ndjenjat dhe kombësia”⁶³. Ndryshe nga realiteti, në to deklaroheshin “ndjenjat e kulluara greke të të gjithë banorëve të distrikteve të Gjirokastrës, Përmetit, Tepelenës, Delvinës dhe Himarës, pavarësisht gjuhës që flisnin dhe fesë që frekuentonin”, vendosmëria e palëkundshme e tyre për të “mos u ndarë në asnjë mënyrë nga nëna e tyre

⁵⁹ AMAE në AIH, Fondi 179, Raport i zëvendëskonsullit të Francës në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë, mars 1913.

⁶⁰ N. Zoi, *vep. e përm.*, f. 59.

⁶¹ AMAE në AIH, Fondi 179, Raport i zëvendëskonsullit të Francës në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë, mars 1913; HHSSt.A.PA.A. në AIH, Vj. 23-12-1220 dhe Vj. 23-40-3993, Raport i konsullit austro-hungarez në Janinë për Bertoldin, Janinë, 23 prill 1913; Letër e shqiptarëve të Epirit për konsullatën Austro-Hungareze në Janinë, Janinë, 7 qershor 1913.

⁶² Η. Γ Μπαράκταρης, *Το κατά τον αγώνα της ανεξαρτησίας της πόλης και επαρχίας Κοριτσάς*, Αθήνα, Π. Α. Πετράρκος, 1916. (Shfrytëzuar materiali në AIH, A-IV-206, Bajraktaris, H.G., “Rreth përpjekjeve për pavarësi të qytetit dhe rrethit të Korçës”, Athinë: “P. A. Petrarkos”, 1916, fl. 11).

⁶³ J. Swire, *vep. e përm.*, f. 145.

Greqi dhe për të rezistuar me të gjitha forcat vendosjen e tyre nën zgjedhën e urryer të shqiptarëve”⁶⁴. Mjaft aktiv u tregua veçanërisht “prijësi i Himarës”, Spiromilo, i cili u angazhua me shkrime të shumta patetike në gazetën Akropolis, duke mbështetur fort bashkimin e Shqipërisë së Jugut me Greqinë⁶⁵. E njëjta linjë u përdor edhe nga shoqatat Panepirote në Egjipt e Sudan.

Për të treguar vëmendjen që politika e Athinës i kushtonte territoreve të pushtuara dhe për të bindur opinionin publik evropian mbi vullnetin e popullatës aty dhe ndjenjat e saj pro-greke, më 15 maj të 1913 princi trashëgimtar i Greqisë, nisi një udhëtim 10 ditor atje. Stacioni i parë i udhëtimit që Manastiri, për të vazhduar më tej në Korçë, Leskovik, Konicë, Përmet, Gjirokastrë dhe Janinë. Në vizitën e tij, trashëgimtari grek i fronit u shoqërua edhe nga nëntë përfaqësues të shtypit grek, francez e britanik, të cilët ndoqën dhe pasqyruan gjerësisht në shtyp, vizitën e tij. Ardhja e princit u shoqërua me masa të rrepta, veçanërisht në zonat që kishin reaguar ndaj politikës greke. Në fund të prillit 1913 me urdhër të autoriteteve greke u larguan nga Korça anëtarët e Misionit Protestant, sjelljet pro shqiptare të të cilëve ishin bërë shqetësuese për autoritetet greke aty⁶⁶. Po kështu u mbyllën edhe shkollat që administroheshin prej Misionit. E njëjta masë u mor edhe ndaj shqiptarëve, të cilët kishin filluar të mbledhnin nënshkrimet e popullsisë për të mbështetur bashkimin e Korçës me Shqipërinë⁶⁷. Arrestime të pamotivuara u bënë dhe tek shqiptarët e Çamërisë, Leskovikut dhe Gjirokastrës⁶⁸. Veprime të tilla synonin të evitonin: shfaqjet e ndjenjave anti greke, kontaktet e shqiptarëve me përfaqësuesit e shtypit të huaj, të cilët gjatë udhëtimit duhej të bindeshin “krejtësisht për dëshirën unanime të shqiptarëve për bashkim me Greqinë”. Masat e marra dhanë rezultate. Princi u prit ngrohtë nga popullsia dhe manifestime “spontane” falënderimi e besnikërie shoqëruan vizitën e tij⁶⁹. Në pritje u shqua veçanërisht entuziazmi i mitropolitit të Korçës, Jermanos.

⁶⁴ *HSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 23-40-3939. Peticion i përfaqësuesve të distriktit të Korçës për Grey-n, Korçë: 6 qershor 1913; *Po aty*, Vj. 23-40-3941. Peticion i popullit të Gjirokastrës për përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Londër, Gjirokastrë: 30 qershor 1913; Peticion i popullsisë së distriktit të Himarës për përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Londër, Himarë: 1 korrik 1913.

⁶⁵ *AIH*, A-IV-213, fl. 55.

⁶⁶ *AQSh*, (Komisioni i 25 vjetorit të vetëqeverimit), Fondi 170, viti 1913, dos. 13, fl. 36-37. Letër e Parashqevi dhe Kristo Dakos për miqtë e tyre, Manastir, 21 shtator 1913.

⁶⁷ *HSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 23-39-3841, Raport i konsullit të Manastirit, për Bertoldin, Manastir, 2 maj 1913.

⁶⁸ *Po aty*, Vj. 23-12-1212, Telegram i konsullit të Janinës për Bertoldin, Janinë, 19 maj 1913.

⁶⁹ Për më shumë shih: *Po aty*, Raporte të konsujve austriakë në Manastir, Vlorë e Janinë, maj 1913.

Por ndërsa nga njëra anë autoritetet e pushtimit nxisnin forcimin e elementit grek dhe mbështesnin reagimin e popullsisë vendase për bashkim me Greqinë, nga ana tjetër ata morën masa për të ndaluar çdo shprehje të ndërgjegjes së tyre kombëtare shqiptare. Autoritetet civile dhe ushtarake greke, u sollën ndaj shqiptarëve si çlirimtarë. Në vazhdimësi ata përdorën ndaj shqiptarëve myslimanë dhe atyre të krishterë, që shfaqnin ndjenja shqiptare, politikën e kërcënimit dhe të ndjekjes sistematike. Për të shmangur reagimin e armatosur të shqiptarëve, menjëherë pas pushtimit filloi çarmatimi i tyre⁷⁰. Armët e grumbulluara u jepeshin popullsisë greke ose asaj filo greke. Numri i arrestimeve dhe burgimeve u rrit⁷¹. Mbështetur në ligjin e datës 14 mars 1913, shqiptarët arrestoheshin kryesisht për përdorim të gjuhës shqipe dhe për prishje të rendit publik. Sakaq pronarët shqiptarë të tokave, filluan të mos njihen si të tillë prej popullsisë greke. Për problemet e tyre, ata nuk gjenin mbrojtjen dhe vëmendjen e duhur nga autoritetet e administratës së pushtimit. Shpesh herë nëpunësit grekë i shfrytëzonin këto raste, për t'i detyruar shqiptarët të merrnin pjesë në të gjitha manifestimet e organizuara në shenjë mirënjohjeje ndaj pushtimit grek dhe në mbështetje të bashkimit me Greqinë.

Atje ku mjetet e sipërshënuara nuk jepnin rezultat, kalohej menjëherë në masa më shtrënguese. Shumë fshatra në zonën e Tepelenës dhe të Kolonjës u dogjën dhe popullsia veçanërisht në Çamëria vazhdoi të dhunohej⁷². Kjo politikë rriti pakënaqësinë e shqiptarëve. Format e reagimit të tyre ishin të ndryshme. Një pjesë vazhdoi zhvendosjen në drejtim të tokave që administroheshin nga Qeveria e Vlorës. Elbasani, Berati dhe veçanërisht Vlora u bënë vendstrehimi i tyre. Një pjesë pranoi të bindej, sikurse pati edhe nga ata që vazhduan rezistencën. Në momente acarimi ata iu përgjigjën me të njëjtën monedhë autoriteteve të pushtimit. Çetat shqiptare vazhduan të ishin aktive. Nga burimet austro-hungareze dhe franceze relatohen djegie fshatrash, madje dhe vrasje ushtarësh greke prej tyre⁷³.

Përfundimi i Luftës së Dytë Ballkanike dhe fitorja e Greqisë, u manifestua edhe në zonat e pushtimit. Numri i ushtarëve dhe oficerëve grekë në

⁷⁰ *Qeveria e Vlorës dhe veprimtaria ...*, Letër e popullit të Fterës për qeverinë e Vlorës, dt. 24 maj 1913; *AMPJ*, Pa vit, dos. 61, fl. 50, Letër e popullsisë së Çamërisë për qeverinë e Vlorës dhe konsullin e Austro-Hungarisë në Vlorë; H. Isufi, *vep. e përm.*, f. 54-55.

⁷¹ *AMPJ*, Pa vit, dos. 61, fl. 50, Letër e popullsisë së Çamërisë për qeverinë e Vlorës dhe konsullin e Austro-Hungarisë në Vlorë.

⁷² *Po aty*, viti 1919, dos. 1, fl. 126-130, Listë e fshatrave të djegura nga grekët në vitet 1913-1914.

⁷³ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 22-9-947; Vj. 23-12-1218, Telegrami i konsullit të Austro-Hungarisë në Vlorë për Ministrinë e Jashtme, Vlorë, 11 dhjetor 1912; *AMAE* në *AIH*, Fondi 179, Raport i zëvendëskonsullit të Francës në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë: mars 1913.

Shqipërinë e Jugut u rrit me ushtarë nga fronti i Maqedonisë⁷⁴. Të ekzaltuar nga fitorja e luftës, oficerët grekë filluan të deklarojnë vendosmërinë e tyre për t'u larguar nga ushtria greke dhe fillimin e punës për formimin e bandave me ushtarë të përgatitur prej tyre⁷⁵. Po hidheshin kështu bazat e një rezistence të armatosur, në dukje e organizuar nga popullsia vendase. Ajo mori formë në kohën e përcaktimit në terren të kufirit shqiptaro-grek nga Komisioni Ndërkombëtar i Kufirit të Shqipërisë së Jugut dhe u aktivizua gjerësisht në kohën kur Fuqitë e Mëdha ishin në procesin e ratifikimit të Protokollit të Firences. Trajtimi dhe analizimi i saj janë qëllim i një artikulli tjetër.

S u m m a r y

THE INVADED AREAS FROM GREECE AND THE DEFINITION OF THE ALBANIAN-GREEK BORDER AT THE LONDON CONFERENCE OF AMBASSADORS (March - August 1913)

The conduct of the Greeks in the invaded territories of south Albania was conditioned from the consideration of the Albanian-Greek border issue at the London Conference of Ambassadors. The meetings of the Greeks with representatives of the Great Powers at the London Conference of Ambassadors and the diplomatic chancelleries demonstrate a constant persistence to possess the invaded territories in south Albania. Until mid June 1913, the Greek diplomacy it achieved to drag out the border issue with Albania, without abandoning its claims there. In this situation, the foreign minister of Britain assessed as the only solution to overcome the crisis, the combination of the Albanian-Greek border issue with that of the Aegean islands. The border issue between Albania and Greece was solved through an acceptable compromise, even though not fully pleasing for the powers that had participated. The union of Korça and Cape Stillo with Albania it took the approval of all the Great Powers only after an agreement was reached between them according to which, the Aegean islands with the exception of Imbros and Tenedos would be given to Greece.

Alongside to the intensive diplomatic activity by the chancelleries of the Great Powers, the focus of the Greek policy was concentrated toward the invaded territories in south Albania. "The good administration" of these territories took a special importance due to the fact that a pro Greek reaction of the population there would have strengthened the Greek character of the region in consideration and the existence of the "Vorio Epirus (Northern Epirus) issue".

The first measure that the Greek government took in the invaded territories in south Albania was related to the administrative reorganisation and their placement under a legal framework similar to that existed in Greece. By means of two proclams were liquidated up till then political and military central authorities by disengaging in this manner the ties with invaded territories with Istanbul and was announced the empowering of the military law in the invaded territories. As

⁷⁴ AMAE në AIH, Fondi 145, fl. 822, Raport i atasheut ushtarak francez në Athinë për ministrin e Luftës, Athinë: 27 dhjetor 1913.

⁷⁵ HHSSt.A.P.A.A. në AIH, Vj. 23-12-1223, Raport i konsullit të Austro-Hungarisë në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë, 9 gusht 1913.

regards the civic, trading, administrative and economical issues, the particular Greek law of 14 March 1913 left in power the existing ottoman legislation. The use of the ottoman legislation discriminated the Albanians. The Albanian nationality was not recognised and as a consequence it was forbidden and punished the use of the Albanian language as well as the opening of the schools in this language. .

After the fulfilment of the legal frame, the focus of the authorities of the invasion was concentrated toward the “win over” of the population of the invaded regions in order to manifest their desire for unification with Greece. On one hand the authorities of the invasion promoted the strengthening of the Greek element and supported the reaction of the local population for unification with Greece. While on the other hand they took measures to halt any expression of their national Albanian identity. In addition, they used toward the Muslim and Christian Albanians that expressed Albanian feelings the policy of intimidation and of systematic persecution. Wherever the means of persuasion gave no results were used more constraining measures. Many villages were burned and Albanian population of Çamëria in particular was violated. Boosted from the victory of the Second Balcanic War the Greek army officers started their work for the formation of bands with soldiers trained by them in order to start the foundations of an armed resistance seemingly organised by the local population.